



Pranuar / Dorezuar Prijmijeno / Prodato Received / Delivery	27 - 12 - 2023	viti god year	3
Organ / Njësia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHTKA	7676 / 2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 1391/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e dhe vendosjeve të ankesave të përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi- anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1391/2023 të datës 08.11.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit [redacted] me adresë: [redacted] kundër Vendimit me numër protokollit Nr.prot.2883 të datës 20.09.2023 të Ministres së Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 27.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1391/2023 të datës 08.11.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Çështja bje në kompetencë të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [redacted] i punësuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit sipas Akt Emërimit të datës 21.06.2012 në pozitën e punës „Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve“, më datë 20.09.2023 Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka nxjerr Vendimin me numër protokollit Nr.prot.2883 përmes të cilit e ka shfuqizuar Akt Emërimit të datës 21.06.2012 të ankuesit, në pozitën e punës „ Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve“.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokoll Nr.prot.2883 të datës 20.09.2023 të Ministres së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, më datë 02.10.2023 përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2982 ne Komisionin e Ankesave për Nëpunësit Publik në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërsa Komisioni i Ankesave me date 30.10.2023 ka nxjerre Vendim me numër protokoll Nr.prot 3478, përmes se cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokoll Nr.prot 3478, të datës 30.10.2023 të Komisionit të Ankesave për Nëpunësit Publik në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 08.11.2023 përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6928/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Qendrën e Studentëve /Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Ndërsa Këshilli më datë 20.11.2023 ka pranuar nga Qendra e Studentëve /Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës. Po ashtu Qendra e Studentëve përmes e-mailit te datës 20.12.2023 ka dërguar ne Këshill listën e deklaramit të statusit të zyrtarëve publikë të miratuar nga DMZP për Qendrën e Studenteve si dhe emalin e datës 20.05.2021 drejtuar DMZP-se përmes se cilit Qendra e Studentëve ka kundërshtuar Deklarimin e statusit te zyrtareve publike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1391/2023 të datës 08.11.2023, të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Bazuar në provat e lëndës rezulton se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 21.06.2012, është i emëruar në pozitën e punës "Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve" në kuadër Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit". Me tutje Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me datë 20.09.2023 ka nxjerr Vendimin me numër protokoll Nr.prot.2883 përmes të cilit e ka shfuqizuar Akt Emërimin e datës 21.06.2012 të ankuesit në pozitën e punës „ *Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve*”.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokoll Nr.prot.2883 të datës 20.09.2023 të Ministres së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 02.10.2023 përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2982 ne Komisionin e Ankesave për Nëpunësit Publik në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërsa Komisioni i Ankesave me date 30.10.2023 ka nxjerre Vendim me numër protokoll Nr.prot 3478, përmes se cilit e ka refuzuar si te pabazuar ankesën e ankuesit dhe sipas këshillës juridike e ka udhëzuar palën që të inicioj konflikt administrativ konform Ligjit për Konfliktet Administrative.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokoll Nr.prot 3478, të datës 30.10.2023 të Komisionit të Ankesave për Nëpunësit Publik në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 08.11.2023 përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6928/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Qendra e Studentëve/Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit përmes Udhëheqësit të Sektorit për Burime Njerëzore gjegjësisht e-malit të datës 20.12.2023 ka dërguar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Listën mbi Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë për Qendrën e Studenteve të miratuar dhe dërguar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë më datë 19.05.2021, ku në bazë të kësaj liste ankuesi gëzon statusin e Nëpunësit të Shërbimit Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, respektivisht lidhur me statusin e ankuesit si dhe në kuptim të pranushmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtar Publik përkatësisht nenit 2, 3 dhe 4 ku është përcaktuar se : "...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... " 3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, ndërsa me nenin 74, paragrafin 1,2 dhe 3 po të këtij ligji është përcaktuar se "1. Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Ankimi paraqitet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit. 3. Shqyrtimi i ankesave është në kompetencën e Komisionit të Ankesave, rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar ne Listën mbi Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë për Qendrën e Studenteve te miratuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstatoi se ne rastin konkret pozita "Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve" në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacioni nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil por e njëjta hyn në kategorinë e Nëpunësve të Shërbimit Publik, e që rrjedhimisht ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil për t'ju shqyrtuar ankesa në Këshillin e Pavarur për Shërbim Civil të Kosovës .

Lidhur me këtë pjesa e V e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësve të Shërbimit Publik, mbi këtë bazë duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe pas konstatimit se ankuesi nuk e ka statusin e Nëpunësit Civil, Kolegji i Këshillit vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1391/2023 të datës 08.11.2023, të



parashtruar nga ankuesi sepse Këshilli shqyrton dhe merr Vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për punësim në Shërbim Civil.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, thekson se "*Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe Nëpunësi Administrativ dhe Mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në Gjykatën kompetente*", si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson se Nëpunësi i Shërbimit Publik fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente, po ashtu në nenin 74 paragrafin 1, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik është përcaktuar se, "*Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankimit e kanë dhe kandidatët në procedurën e konkurrimit*" ndërsa paragrafi 3, 4 dhe 5 përcakton se, "*Shqyrtimi i ankesave është në kompetencën e Komisionit të Ankesave. Komisioni i Ankesave krijohet: 3.1. në çdo administratë të institucionit të shërbimit publik; 3.2. në çdo ministri për administratën e njësisë të Shërbimit Publik në kompetencë të administratës shtetërore; dhe 3.3. në çdo komunë për nëpunësit e administratës së njësisë së shërbimit publik në kompetencë të komunës*" 4. *Ankesa shqyrtohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga paraqitja e saj. 5. Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente*". Andaj në këtë kuptim nëpunësit e Shërbimit Publik fillimisht duhet të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në Gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenin 6 paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli nuk është kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1391/2023 të datës 08.11.2023, të parashtruar nga ankuesi sepse Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbim Civil.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër .nr.1391/2023 të datës 08.11.2023, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në kuptim të nenit 64 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku është përcaktuar se "*Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës*", dhe pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 24 paragrafi 4 ku theksohet se: "*Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe Nëpunësi Administrativ dhe Mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në Gjykatën kompetente*".

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA me numër A.nr.1391/2023.

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;